



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0627**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D. Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Marisa” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike” me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1, me 20/09/2024, mori:

## **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Marisa” SH.P.K. me nr. 2024/0627, e datës 12/07/2024, ndaj AK “KOMUNA E GJAKOVËS” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike” me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-

2. Mbetet në fuqi, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58), për dhënie të një kontrate të datës 24.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit të lartë cekur si në pikën 1 të dispozitivit.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës ankimore, kurse Ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthimin e mjeteve sipas nenit 31 paragrafi 6, të Rregullores për Punën e OSHP, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 24.11.2023 “KOMUNA E GJAKOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Re-Tender-

Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike” me nr. të prokurimit: 632-23-13225-5-1-1. Ndërsa me datën 24.06.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me te cilin ka shpërblyer me kontratë OE “Joss Krasniqi & Berisha Com&Fonderia.”

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: - **punë**, vlera e parashikuar e kontratës: 1,570,000 €.

Me 01.07.2024, OE “Marisa” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 04.07.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12/07/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Marisa” SH.P.K., me nr. 2024/0627 për lidhur me aktivitetin “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike” me nr. të prokurimit: 632-23-13225-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Marisa” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Vendimi i marrë nga AK Komuna e Gjakovës është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe me të gjitha rregullat e saj.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës ka publikuar tenderin me titull: “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike”

Komuna e Gjakovës ka bërë shkelje duke rekomanduar një operator ekonomik të papërgjegjshëm dhe duke shkelur Nenin 1 (Qëllimi), Nenin 6 dhe Nenin 7.

Pretendimi 1: Për Operatorin Ekonomik Joos Krasniqi & Berisha Com & Fonderia EE janë paraqitur disa autorizime të cilat janë më të vjetra se ndryshimi dhe korrigjimi i dosjes së tenderit. Si dëshmi, ju paraqesim autorizimet dhe ndryshimet e dosjes së tenderit. Ky aktivitet i prokurimit është ndryshuar nga OSHP, e cila ka kërkuar të anulohet dhe të ndryshohen kriteret e dosjes së tenderit.

Siç shihet më poshtë, data e përpilimit të dosjes së tenderit dhe e paramasës është shumë më e re se data e autorizimeve. Në qoftë se dosja e tenderit nuk ishte ndryshuar dhe përpiluar pas datave të autorizimit këta autorizimi do të ishin të vlefshëm pra sipas dëshmisë se paraqitur shihet qartë se autorizimet në fjale janë të pavlefshëm.

Dëshmi: Autorizimet me data te ndryshme me te vjetra se Korrigjimi i Dosjes se Tenderit

Siç shihet ky autorizim është me i vjetër se 6 muaj

Pretendimi 2: GOE Joos Krasniqi & Berisha Com & Fonderia EE ka paraqitur një marrëveshje e cila nuk i plotëson kriteret për marrëveshje konsorciumi, pasi siç shihet në pikën e marrëveshjes, këta OE kanë ndarë në përqindje (%) ekzekutimin e punimeve dhe jo caktimin e liderit, siç kërkohet në dosjen e tenderit. Pra, bashkimi i këtyre dy kompanive, Berisha Com dhe Fonderia EE, bën 60%, kurse lideri 40%.

Sipas dokumenteve dhe dëshmive, këtij GOE i mungon marrëveshja e konsorciumit dhe marrëveshja e paraqitur është në kundërshtim me dosjen e tenderit, pasi për të qenë lider duhet të jesh 51% i marrëveshjes.

Dëshmi: Marrëveshja e paraqitur nga GOE Joos Krasniqi&Berisha Com &Fonderia EE

Kërkesa e Dosjes se tenderit Dëshmi:

Pretendimi 3: GOE Joos Krasniqi & Berisha Com & Fonderia EE ka paraqitur një kamion special, ku kriteri i dosjes së tenderit është kështu: Kamion me shportë...

Ne kemi bere kërkim ne Google dhe kemi pare se ky mjet është kombi apo kamionët pra ky kriter është i pa plotësuar pasi qe edhe ne librezën e automjetit nuk ceket qe është me shport.

Si dëshmi gjeni me poshtë librezën:

Sipas kushteve dhe kriterëve të dosjes së tenderit, GOE Joos Krasniqi & Berisha Com & Fonderia EE është i papërgjegjshëm në kushtet themelore të kësaj kontrate. Andaj, Komisioni Vlerësues si dhe Zyra e Prokurimit Publik kanë bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik duke rekomanduar për kontratë një GOE të papërgjegjshëm. Kjo ofertë duhet refuzuar.

GOE Infraplus & Selmans Network është gjithashtu i papërgjegjshëm, edhe pse kjo dosje e tenderit është përgatitur për këtë GOE dhe është favorizuar, pasi që OE Selmans Network ka një marrëveshje me një kompani bullgare për këto produkte të cilat janë në specifikimet e dosjes së tenderit. Duke u bazuar se në disa autoritete të ndryshme janë të njëjtat kriteret dhe është i njëjti OE i shpallur fitues.

Pretendimi 1: GOE Infraplus dhe Selmans Network ka të njëjtin defekt sikur GOE i rekomanduar, pasi që ka autorizimet me data më të vjetra se korrigjimi dhe përpilimi i dosjes së tenderit dhe paramasës së tenderit.

Dëshmitë gjeni më poshtë:

Dëshmi gjeni Autorizimet dhe Garancionet pa data ku autorizimi dhe garancioni vlen prej datës se lëshimit ose tregojnë datën e lidhjes se marrëveshjes. Pra çdo dokument I cili nuk ka date te lëshimit është I pa vlefshëm.

Pretendimi 2:GOE Infraplus dhe Selmans Network kanë të njëjtin defekt sikurse GOE i rekomanduar, pasi kanë marrëveshje të konsorciumit me data më të vjetra se korrigjimi dhe përpilimi i dosjes së tenderit dhe paramasës së tenderit. Sipas dëshmive të paraqitura, ky GOE është i papërgjegjshëm, pasi nuk i është referuar dosjes së tenderit.

Dëshmitë i gjeni më poshtë:

Pretendimi 3. GOE Infraplus dhe Selmans Network kanë paraqitur në dosjen e tenderit një listë të projekteve që nuk përputhet me specifikatën e dosjes së tenderit. Dosja e tenderit përcakton qartë numrin e prokurimit dhe emrin e aktivitetit për secilën projekt të destinuar.

Ky GOE ka paraqitur dy lista të cilat nuk kanë emër për cilin projekt janë të destinuar dhe as numër të prokurimit dhe ky kriter nuk është plotësuar dhe duhet refuzuar kjo Oferte pasi që ky ankesë nuk është I dosjes së tenderit.

Dëshmitë gjeni më poshtë

Listë e Kontratave Selmans.

Lista e Kontratave Infraplus

Dëshmi gjeni Listën e Projekteve sipas DT

Pretendimi 4. GOE Infraplus dhe Selmans Network nuk kanë përmbushur kriterin e Dosjes së Tenderit që kërkon që automjetet të regjistrohen në datën e dorëzimit të Tenderit. Siç është specifikuar në kërkesën e Dosjes së Tenderit, ky kriter është eliminues dhe mosplotësimi i tij duhet të çojë në shpalljen e GOE-së si të papërgjegjshme. Specifikata e Dosjes së Tenderit kërkon që automjetet të jenë të regjistruara në datën e dorëzimit të tenderit. Mosplotësimi i këtij kriteri bën që oferta e GOE Infraplus dhe Selmans Network të mos përmbushë kushtet e nevojshme për pranimin e saj pasi që është kriter eliminues mos plotësimi i kërkesave të Dosjes së Tenderit, dhe si dëshmi do ju bashkëngjisim librezën e kamionit të pa regjistruar

Dëshmi gjeni listën e makinerisë dhe Librezën kamionit me shport.

Pretendimi 5. GOE Infraplus dhe Selmans nuk ka plotësuar as këtë kriter të DT ku në kërkesën e DT është kërkuar që automjetet e regjistruar duhet të kenë validitet të regjistrimit

Ky Goe nuk e ka plotësuar as këtë kriter pasi që në listën e Makinerisë ka paraqitur një kamion me kran por i cili nuk ka regjistrim.

Dëshmi gjeni listën e makinerisë së paraqitur si dhe dëshminë e librezës

Regjistrimi është i vlefshëm deri me datë 28/02/2024 kurse dorëzimi i tenderit është me datë 13/05/2024

Pretendimi 5. GOE Infraplus dhe Selmans Network nuk kanë përmbushur kriterin e Dosjes së Tenderit që kërkon që Ofruesi të paraqesë garancionin për produktet. Selmans Network ka një marrëveshje për distribuim të materialeve të kompanisë ENCHEO ENCHEVE-ETE LTD.

Por garancioni për punë nuk mund të lëshohet nga një distributor, por vetëm nga prodhuesi. OE Selmans ka lëshuar garancion kompanisë se vet apo te themi me ndryshe i ka lëshuar garancion vetvetiu për produktet që nuk i prodhon vet ,gjë që është në kundërshtim me rregullat DT

Ne qoftë se nuk je prodhues nuk mund të lëshoni as garancion por vetëm shitjen dhe reklamimin ose diçka të ngjashme

Pra ky kriter është i pa plotësuar sipas dosjes së tenderit dhe kjo ofertë duhet refuzuar

Dëshmitë i gjeni me poshtë ku prodhuesi nuk i jep të drejtë të garancionit për produktet e prodhuar nga ai por vetëm shitjen e tij.

Sipas kushteve dhe kriterëve të dosjes së tenderit, GOE Infraplus & Selmans Network është i përgjegjshëm në kushtet themelore të kësaj kontrate. Komisioni Vlerësues dhe Zyrja e Prokurimit Publik kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik duke rekomanduar një GOE të përgjegjshëm për kontratë.

Bazuar në këto argumente, është e qartë që oferta e GOE Infraplus & Selmans Network duhet të refuzohet për shkak të mos përmbushjes së kriterëve.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës nuk ka bërë vlerësim të drejtë dhe nuk ka respektuar Nenin 72 të LPP-së lidhur me eliminimin e Grupit tone.

Eliminim për dritën është eliminim skandaloz pasi që ne kemi dy autorizime me kompaninë turke dhe me Kompaninë Kosovare Elektrostublla dhe të dy këto kompani kanë lloje të ndryshme të llampave dhe ju dëshmojmë sipas specifikave të DT.

Eliminimi lidhur me inçin e Makinerisë ne ju sqarojmë se ne të njëjtën ditë dhe të njëjtë orë kemi pasur dy tenderë dhe ne dy tenderët është kërkuar Inçin i makinerisë dhe është ngarkuar gabimisht ku si rrjedhor ju dëshmojmë se e kemi në listën e stafit dhe mund të ju dërgojmë kontratën e inçit për këtë projekt.

Shtojcë:

Autoriteti kontraktues nuk na është përgjigjur në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim për pretendimin nr 4-5 që kanë të bëjnë me GOE Infraplus dhe Selmans Network sh.p.k

Pas të gjitha këtyre të dhënave dhe dëshmive të gjetura në ofertat e tyre , kërkojmë nga Oshp që të kthejë lëndën në rivlerësim dhe të shpallë të përgjegjshëm GOE-të e rekomanduara: Joos Krasniqi & Berisha Com & Fonderia EE si dhe GOE Infraplus & Selmans Network.

Gjithashtu, të aprovet ankesë dhe të shpallemi fitues GOE Marisa sh.p.k Toifor & Nsht Viktory Com Pjeter Qerimi B.I.

AK Komuna e Gjakovës ka shkelur Ligjin e Prokurimit Publik duke shpallur një GOE të papërgjegjshëm. Në qoftë se Ligji i Prokurimit Publik nuk zbatohet, ne garantojmë se do të dërgojmë lëndën pran organeve kompetente dhe do të kërkojmë që OSHP-ja të ndëshkojë dhe të revokojë licencën e zyrtarit të prokurimit publik për mos zbatim dhe shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik. Autoriteti Kontraktues duhet të zotohet për menaxhimin dhe ruajtjen e fondit publik, dhe për zbatimin e Ligjit të Prokurimit Publik në mënyrë të rregullt.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Marisa” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 Qëllimi të LPP-së Nr. 04/L-042, AK ka shkelur nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti të LPP-së Nr. 04/L-042, AK ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së Nr. 04/L-042, AK ka shkelur nenin 28 Specifikimet teknike AK ka shkelur Neni 37 Mostrat e Tenderit Rregullorja Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së Nr. 04/L-042, AK ka shkelur nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës të LPP-së Nr. 04/L-042, AK ka shkelur nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të LPP-së Nr. 04/L-042.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Grupi Operatorëve ekonomik “Marisa Sh.p.k. & Toifor sh.p.k. & NSHT Viktory Com,, me dt.01.07.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-Tender- Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike”, Nr. i prokurimit- 632-23-13225-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-004-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.07.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Ju si Grupi i Operatorëve Ekonomik jeni eliminuar sepse për produktet për pozicionet :193,197, keni dorëzuar një specifikim teknik apo test raport për një produkt që bazuar në transportin e këtij produkti vërehet qartë se nuk është sipas kërkesave të dosjes së (tenderit dhe parapasës. Sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe pararnasës në pozicionin 193 dhe 197 kërkohet.

Pozi.-193-Fumizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriçues LED-LAMBARIO -LT33-09422 ose e ngjashme me karakteristika minimale:

Fuqia e trupit ndriçues LED>90W

Puna në temperatures:>-20 °C deri +40 °C

Faktori i fuqisë:>0.90

Specifikimi Fotometrik:

Fluksi i dritës: >10800lm

CRI: Ra>70

Ngjyra e temperaturës -NatyrJe:4000-5000K

Specifikimi Mekanik:

Mbrojtja :> IP65-IK08

Garancioni:>5 vite

-Ndërsa sipas test raportit të prezantuar nga OE:

Fuqia e trupit ndriqis: 51.42 W me e vogël se kërkesa ku kërkohet e barabarta ose me e madhe se 90 W

Fluksi i dritës 6753.3 lm, me e vogël se kërkesa ku kërkohet e barabartë ose më e madhe se 10800 lm

PozL-197.Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit ndriqes LED-LAMBARIO -LT45-09122 ose e ngjashme me karakteristika minimale:

Fuqia c trupit ndriqes LED>100W

Dimensionct:>ø300x135x75mm

Puna ne temperaturë:>-20 °C deri +40 °C

Specifikimi Fotometrik:

Fluksi i dritës: >900<)lm

Ngjyra c temperaturës-Natyralc:4000-5000K

Specifikimi Mekanik:

Mbrojtja :> IP65

Garancioni:>2 vite

-Ndërsa sipas test raportit të prezantuar nga OE:

Fuqia e trupit ndriqis: 51.42W me e vogël se kërkesa ku kërkohet e barabartë ose me e madhe se 100W

Fluksi i dritës 6753.3 lm, ine c vogël se kërkesa ku kërkohet c barabartë ose më e madhe se 9000 lm

Ju si Grupi i Operatorëve Ekonornik keni prezantuar Kontratë mbi vepër për inxhinierin e Makinerisë për një projekt tjetër “Ndërtimi i objekteve në K.e FSK-së në Gjakovë, Beishë dhc

Melnicë në ndarë tri pjesë, që është në kundërshtim me kërkesat FDT-së

Pretendimet e juaja për GOE Joss Krasniq -Bazë & BerishaCom & Fonderia E & E

Pretendimi juaj se autorizimet janë in data më lë vjetra se korrigjimi i dosjes nuk qëndron, sepse ky është i njëjti aktivitet dhe nuk ka ndryshim në paramas dhe produkt edhe pse është bere korrigjimi i dosjes;

Pretendimi juaj i dytë gjithashtu nuk qëndron, sepse në marrëveshjen e konzorciumit thuhet: "Palët deklarojnë se janë marrë vesh që kryesuese e këtij bashkimi të shoqërive të jetë shoqëria Joos Krasniqi-Bazë".

Pretendimi juaj lidhur me atë se lideri i grupit duhet të plotësoj 51% të marrëveshjes, sqarojmë se kjo kërkesë ka të bëj me kërkesat mbi mundësitë teknike dh/ose profesionale, kurse përqindjet e paraqitura në marrëveshjen e konzorciumit kanë të bëjnë me ndarjen e detyrave brenda anëtarëve të konzorciumit, prandaj edhe ky pretendim i juaji nuk qëndron;

Sa i përket kamionit me shportë, Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka plotësuar kërkesën e Autoritetit kontraktues në FDT-ë;

Pretendimet e juaja për GQE "Infraplus & Selmans Network

Pretendimi juaj se autorizimet janë me data më te vjetra se korrigjimi i dosjes nuk qëndron, sepse ky është i njëjti aktivitet dhe nuk ka ndryshim në paramas dhe produkte edhe pse është bërë korrigjimi i dosjes;

Pretendimi juaj lidhur me marrëveshjen e konzorciumit nuk qëndron, sepse i njëjti ka plotësuar kërkesën e Autoritetit kontraktues në FDT-ë;

Pretendimi juaj lidhur me listën e kontratave , nuk qëndron, sepse nuk kërkohet shënimi i emrit të aktivitetit e as nr. prokurimit; Pretendimi juaj lidhur me garancionin nuk qëndron.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 19.07.2024 ka autorizuar ekspertit shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0627/2024, ndërsa me datë 08.08.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0627 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr



parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Marisa” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0627 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës: Fillimisht sqarojmë se OE ankues “Marisa” nuk është lider i konzorciumi dhe i njëjti nuk ka bashkangjitur ankesës ndonjë autorizim të veçanta për përfaqësim të grupit në OSHP.

Megjithatë në pajtim me dispozitat e nenit 114 të par.1 të LPP-së më poshtë gjeni përgjigjet në pretendimet ankimore.

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 627/24 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, pasi grupi i OE0-ve ka ofruar autorizime të vjetra, më konkretisht se dosja e tenderit është shumë më e re se autorizimet e OE.

Mendimi ekspertit shqyrtues është se përderisa autorizimet mbajnë numrin e njëjtë të prokurimit dhe titullin e njëjtë të prokurimit, të njëjtat nuk mund të konsiderohen të papranueshme.

Autorizimi nga BENITO mban titullin “PARAMASA REHABILITIMI DHE NDERTIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE in KOSOVO”, ndërsa titulli këtij aktiviteti është “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike” me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-1Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Në autorizim të OE në vend të “Re-tender” , shënon “Paramasa”, megjithatë nuk mund të japim konstatim ose rekomandim që kjo të përdoret si arsye për eliminimi të OE.

Ndërsa autorizimet nga Betonika dhe Vlora Com doo mbajnë numërin e njëjtë të prokurimit me këtë aktivitet të prokurimit.

Ndërsa autorizimi nga Encho Enchev është i lëshuar për një aktivitet të prokurimit me numër tjetër, gjegjësisht “632-22-5656-1-2-1”, që del të jetë aktivitet tjetër i prokurimit, dhe si tillë konsiderojmë se është i papranueshëm.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore për autorizime janë pjesërisht të bazuara.

#### Pretendimi nr.2

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar në marrëveshje të grupit është deklaruar se lideri do të kryej 40% të punimeve, ndërsa sipas OE ankues lideri duhet të jetë 51% e marrëveshjes.

Sqarojmë se kërkesa për 51% lideri ka qenë për qarkullim financiar, jo për përqindje të punëve që do të kryhen.

Kërkesa dosjes:

“Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 3,140,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 51% të vlerës së qarkullimit.”

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor për është i pabazuar.

#### Pretendimi nr.3

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar në vend të kamionit me shportë ka ofruar kombi/kamionët Iveco tipi 35.8 dhe në librezë nuk ceket se është me shportë.

Gjatë hulumtimeve të mëtutjeshme kemi vjetur se Iveco 35.8 në librezë të qarkullimit është “kamion special me 2 dyer”, ndërsa në librezë nuk shënon se është me shportë, mirëpo kjo nuk është konfirmim se kamioni nuk është me shportë pasi jo gjithmonë të gjitha detajet e automjeteve gjenden në librezën e qarkullimit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor për është pjesërisht pabazuar.

#### Pretendimi nr.4

OE ankues pretendon se kjo dosje e tenderit është përgatitur për OE Selmans dhe se ky OE është favorizuar nga AK.

Fillimisht sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk është OE:”Selmans” po është një OE tjetër.

Po ashtu sqarojmë se kjo dosje e tenderit është korrigjuar përmes vendimit të OSHP-së, dhe pas publikimit të dosjes së re, OSHP nuk ka pranuar ankesë tjetër sa i përket kriterëve të dosjes për këtë aktivitet të prokurimit.

#### Pretendimi nr.5

Sikurse për OE e rekomanduar për kontratë, po ashtu edhe për OE Selmans, OE ankues pretendon se i njëjti ka autorizimet e vjetra të cilat i konsideron të papranueshme.

Sqarojmë se autorizimet të cilat mbajnë numrin e njëjtë me këtë aktivitet të prokurimit, dhe marrëveshjet për furnizime të cilat nuk janë të kufizuara vetëm për këtë projekt nuk mund të konsiderohen si të papranueshme.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor për është i pabazuar.

Pretendimi nr.6

OE pretendon se OE Selmans marrëveshjen e konzorciumit e ka me data të vjetra. edhe në këtë rast OE selmans ka marrëveshje me Infra plus, në të cilën marrëveshje shënjon numri dhe titulli i po këtij aktvitiiti të prokurimit, andaj nuk mund ti konsiderojmë të papranueshme.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor për është i pabazuar.

Pretendimi nr.7

Pretendimi tjetër ankimorë është se OE Selmans&Infraplus nuk plotësojnë kërkesën e dosjes për punë të ngjashme.

Pas analizimit të ofertës së OE Selmans&Infraplus vlerësojmë se ky OE plotëson dhe në masë të madhe tejkalon kërkesën e AK-së për punë të gjëshme në vlerë 2,355.000€ në tri vitet e fundit.

Pretendimi nr.8

OE pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar automjete (kamion) me regjistrim të skaduar.

Vlerësimi i ekspertit është se përkundër kërkesës së dosjes, skadimi i regjistrimit të kamionit konsiderojmë se është devijim i vogël i cili nuk përbën ndryshim apo devijim nga kushtet dhe kërkesat e dosjes.

Pretendimi nr.9

OE ankues pretendon se OE Selmans ka ofruar grancion ne emër të vet e nuk ka ofruar garancion nga prodhuesi bullgar Enchio Enchev.

Pas analizimit të ofertës së OE, kemi gjetur se i njëjti është distributor me të drejta ekskluzive për shitje të produkteve në Republikën e Kosovës.

Po ashtu sipas kësaj marrveshje Distrubutori merr përsipër shërbimet për produktet e prodhuesit në territorin e Kosovës ndërsa shpenzimet lidhur me defektet që mund të ndodhin gjatë periudhës garantuese mbulohen nga prodhuesi.

Për ekspertin shqyrtues ky dokument është i pranueshëm, mirëpo për çdo rast AK me rastin eventual të rivlerësimit mund të kërkoj konfirmim edhe direkt nga prodhuesi.

Pretendimi nr.10

Sa i përket arsyeve të eliminimit të OE ankues, i cili potencon se përveç trupave ndriçuese për të cilat ka ofruar test raport, në ofertë kanë edhe produkte të të prodhuesve tjerë, japim sqarimet si në vijim.

Test raportet për trupat ndriçuese (të kërkuara me dosje te tenderit) të cilat i ka ofruar OE ankues dëshmojnë se produkti ka veti funksionale më të dobëta se ato që janë kërkuar në dosje, konkretisht fuqia e dritës.

Ndërsa pretendimi se OE ka edhe prodhues tjerë, në katalogun tjetër prap kemi gjetur se trupi ndriçues nuk ka fuqinë e kërkuar në dosje të tenderit për 10800 Lumen.

Mirëpo edhe sikur katalogu tjetër (produkt tjetër nga i dëshmuar me test raport) të plotësonte kërkesat e dosjes, prap do të i është i papranueshëm pasi kjo nënkupton se OE ankues ka ofertuar me variante, ndërsa variantet nuk kanë qenë të lejuara me këtë dosje të tenderit.

Pretendimi nr.11

Sa i përket arsyes së eliminimit se Inxhinierii i makinerisë me kontratë mbi vepër është i emëruar për një projekt tjetër, OE ankues pretendon ese ky person është staf rezervë/mbështetës dhe se kompania ka inxhinier të tjerë që plotësojnë këtë kërkesë, pas analizimit të ofertës së OE ankues, tek follderi “Stafi Profesional” për inxhinierin e makinerisë e ka prezantuar z/Avdyll Prekadini, ku në marrëveshje shënon emri dhe numri i një prokurimit tjetër , andaj konsiderojmë se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Ex – 627 – 24

Sqarim Hyrës: Fillimisht sqarojmë se OE ankues “Marisa” nuk është lider i konzorciumi dhe i njëjti nuk ka bashkangjitur ankesës ndonjë autorizim të veçanta për përfaqësim të grupit në OSHP.

Megjithatë në pajtim me dispozitat e nenit 114 të par.1 të LPP-së më poshtë gjeni përgjigjet në pretendimet ankimore.

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 627/24 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, pasi grupi i OE0-ve ka ofruar autorizime të vjetra, më konkretisht se dosja e tenderit është shumë më e re se autorizimet e OE.

Mendimi ekspertit shqyrtues është se përderisa autorizimet mbajnë numrin e njëjtë të prokurimit dhe titullin e njëjtë të prokurimit, të njëjtat nuk mund të konsiderohen të papranueshme.

Autorizimi nga BENITO mban titullin “PARAMASA REHABILITIMI DHE NDERTIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE in KOSOVO”, ndërsa titulli këtij aktiviteti është “Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndërtimi i hapësirave publike” me numër të prokurimit 632-23-13225-5-1-

1Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Në autorizim të OE në vend të “Re-tender” , shënon “Paramasa”, megjithatë nuk mund të japim konstatim ose rekomandim që kjo të përdoret si arsye për eliminimi të OE.

Ndërsa autorizimet nga Betonika dhe Vlora Com doo mbajnë numrin e njëjtë të prokurimit me këtë aktivitet të prokurimit.

Ndërsa autorizimi nga Encho Enchev është i lëshuar për një aktivitet të prokurimit me numër tjetër, gjegjësisht “632-22-5656-1-2-1”, që del të jetë aktivitet tjetër i prokurimit, dhe si tillë konsiderojmë se është i papranueshëm.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore për autorizime janë pjesërisht të bazuara.

Pretendimi nr.2

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar në marrëveshje të grupit është deklaruar se lideri do të kryej 40% të punimeve, ndërsa sipas OE ankues lideri duhet të jetë 51% e marrëveshjes.

Sqarojmë se kërkesa për 51% lideri ka qenë për qarkullim financiar, jo për përqindje të punëve që do të kryhen.

Kërkesa dosjes:

“Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 3,140,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 51% të vlerës së qarkullimit.”

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor për është i pabazuar.

Pretendimi nr.3

OE ankues pretendon e OE i rekomanduar në vend të kamionit me shportë ka ofruar kombi/kamionët Iveco tipi 35.8 dhe në librezë nuk ceket se është me shportë.

Gjatë hulumtimeve të mëtutjeshme kemi vjetur se Iveco 35.8 në librezë të qarkullimit është “kamion special me 2 dyer”, ndërsa në librezë nuk shënon se është me shportë, mirëpo kjo nuk është konfirmim se kamioni nuk është me shportë pasi jo gjithmonë të gjitha detajet e automjeteve gjenden në librezën e qarkullimit.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor për është pjesërisht pabazuar.

Pretendimi nr.4

OE ankues pretendon se kjo dosje e tenderit është përgatitur për OE Selmans dhe se ky OE është favorizuar nga AK.

Fillimisht sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk është OE:”Selmans” po është një OE tjetër.

Po ashtu sqarojmë se kjo dosje tenderit është korrigjuar përmes vendimit të OSHP-së, dhe pas publikimit të dosjes së re, OSHP nuk ka pranuar ankesë tjetër sa i përket kritereve të dosjes për këtë aktivitet të prokurimit.

#### Pretendimi nr.5

Sikurse për OE e rekomanduar për kontratë, po ashtu edhe për OE Selmans, OE ankues pretendon se i njëjti ka autorizimet e vjetra të cilat i konsideron të papranueshme.

Sqarojmë se autorizimit të cilat mbajnë numrin e njëjtë me këtë aktivitet të prokurimit, dhe marrëveshjet për furnizime të cilat nuk janë të kufizuara vetëm për këtë projekt nuk mund të konsiderohen si të papranueshme.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor për është i pabazuar.

#### Pretendimi nr.6

OE pretendon se OE Selmans marrveshjen e konzorciumit e ka me data të vjetra.

edhe në këtë rast OE selmans ka marrëveshje me Infra plus, në të cilën marrëveshje shënojnë numri dhe titulli i po këtij aktiviteti të prokurimit, andaj nuk mund ti konsiderojmë të papranueshme.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor për është i pabazuar.

#### Pretendimi nr.7

Pretendimi tjetër ankimorë është se OE Selmans&Infraplus nuk plotësojnë kërkesën e dosjes për punë të ngjashme.

Pas analizimit të ofertës së OE Selmans&Infraplus vlerësojmë se ky OE plotëson dhe në masë të madhe tejkalon kërkesën e AK-së për punë të gjashme në vlerë 2,355.000€ në tri vitet e fundit.

#### Pretendimi nr.8

OE pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar automjete (kamion) me regjistrim të skaduar.

Vlerësimi i ekspertit është se përkundër kërkesës së dosjes, skadimi i regjistrimit të kamionit konsiderojmë se është devijim i vogël i cili nuk përbën ndryshim apo devijim nga kushtet dhe kërkesat e dosjes.

#### Pretendimi nr.9

OE ankues pretendon se OE Selmans ka ofruar grancion ne emër të vet e nuk ka ofruar garancion nga prodhuesi bullgar Enchio Enchev.

Pas analizimit të ofertës së OE, kemi gjetur se i njëjti është distributor me të drejta ekskluzive për shitje të produkteve në Republikën e Kosovës.

Po ashtu sipas kësaj marrëveshje Distrubutori merr përsipër shërbimet për produktet e prodhuesit në territorin e Kosovës ndërsa shpenzimet lidhur me defektet që mund të ndodhin gjatë periudhës garantuese mbulohen nga prodhuesi.

Për ekspertin shqyrtues ky dokument është i pranueshëm, mirëpo për çdo rast AK me rastin eventual të rivlerësimit mund të kërkoj konfirmim edhe direkt nga prodhuesi.

#### Pretendimi nr.10

Sa i përket arsyeve të eliminimit të OE ankues, i cili potencon se përveç trupave ndriçuese për të cilat ka ofruar test raport, në ofertë kanë edhe produkte të të prodhuesve tjerë, japim sqarimet si bën vijim.

Test raportet për trupat ndriçuese (të kërkuara me dosje te tenderit) të cilat i ka ofruar OE ankues dëshmojnë se produkti ka veti funksionale më të dobëta se ato që janë kërkuar në dosje, konkretisht fuqia e dritës.

Ndërsa pretendimi se OE ka edhe prodhues tjerë, në katalogun tjetër prap kemi gjetur se trupoi ndriçues nuk ka fuqinë e kërkuar në dosje të tenderit për 10800 Lumen.

Mirëpo edhe sikur katalogu tjetër (produkt tjetër nga i dëshmuar me test raport) të plotësonte kërkesat e dosjes, prap do të i është i papranueshëm pasi kjo nënkupton se OE ankues ka ofertuar me variante, ndërsa variantet nuk kanë qenë të lejuara me këtë dosje të tenderit.

#### Pretendimi nr.11

Sa i përket arsyes së eliminimit se Inxhinieri i makinerisë me kontratë mbi vepër është i emëruar për një projekt tjetër, OE ankues pretendon ese ky person është staf rezervë/mbështetës dhe se kompania ka inxhinier të tjerë që plotësojnë këtë kërkesë, pas analizimit të ofertës së OE ankues, tek follderi “Stafi Profesional” për inxhinierin e makinerisë e ka prezantuar z/Avdyl Prekadini, ku në marrëveshje shënon emri dhe numri i një prokurimit tjetër , andaj konsiderojmë se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Marisa” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të

konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Marisa" SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën me nr. 2024/0627, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës ka gjetur se ankesat duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar, por e cila nuk kanë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Re-Tender-Rehabilitimi dhe ndertimi i hapsirave publike"., me numër të prokurimit: 632-23-13225-5-1-1, iniciuar nga (AK) – Komuna e Gjakovës.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues gjatë, ekzaminimit, administrimit të provave si dhe në konstatimet e raportit të ekspertit shqyrtues, mund të konstatohet qartë se OE ankues me të drejtë është eliminuar nga AK, ngase ankuesi ka ofruar Test raportet për trupat ndriqese (të kërkuara me dosje të tenderit) që dëshmojnë se produkti ka veti funksionale më të dobëta se ato që janë kërkuar në dosje, konkretisht fuqia e dritës dhe se trupoi ndriqes nuk ka fuqinë e kërkuar në dosje të tenderit për 10800 Lumen. Edhe Paneli Shqyrtues ashtu sikurse eksperti shqyrtues thekson se edhe sikur katalogu tjetër (produkt tjetër nga i dëshmuar me test raport) të plotësonte kërkesat e dosjes, prape do të ishte i papranueshëm pasi kjo nënkupton se OE ankues ka ofertuar me variante, ndërsa, variantet nuk kanë qenë të lejuara me këtë dosje të tenderit.

Po ashtu ankuesi ka prezantuar edhe një inxhinier i makinerisë me kontratë mbi vepër i cili është emëruar për një projekt tjetër, andaj, PSH ashtu sikurse eksperti shqyrtues konsideron se kjo nuk është konform kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Lidhur me pretendimet ankimore tjera ndaj OE të rekomanduar për kontratë, PSH konsideron se në disa prej tyre tek ankesa 2024/0625 janë dhënë përgjigje e në disa prej tyre duke përfshirë



edhe pretendimet ankimore ndaj OE Selmans Network SHPK, i mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të mbetet në fuqi vendimi i AK, sepse aplikimi i devijimeve të vogla siç përcakton edhe legjislacioni në fuqi konkretisht neni 59 par. 4 të LPP-së, ku përgjegjësinë ja atribuon autoritetit kontraktues, andaj mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit Kontraktues aplikimi i kësaj norme, ashtu siç e përcakton edhe dispozita e referuar.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe

realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Marisa SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: